



Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI NR:1

NR I VENDIMIT: KPCC/D/A/114/2011

DATA E VENDIMIT: 22/06/2011

Komisionerë Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler

URDHËR

(1) Në secilën prej njëzet kërkesave të identifikuara në pjesën A të listës së bashkëngjitur, Komisioni

vendos që

Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka dëshmuar pronësinë për pronën e kërkuar, apo për pjesën e tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;

(2) Në secilën prej pesë kërkesave të identifikuara në pjesën B të listës së bashkëngjitur Komisioni vendos që kërkesa të hidhet poshtë;

(3) Në secilën nga njëzet kërkesat e identifikuara në pjesën A më sipër, Komisioni

urdhëron që

(a) *Paraqitësit të kërkesës apo bartësit e së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, t'i jepet posedimi i pronës së kërkuar;*

(b) *Çdo person i cili ka uzurpuar pronën, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij urdhri; dhe*

(c) *Nëse çdo person që ka uzurpuar pronën, i cili dështon të përmbushë urdhrin për lirimin e pronës brenda kohës së dhënë, të dëbohet nga prona;*

(4) Në secilën kërkesë të përmendur në kolonat përkatëse të pjesës A të listës së bashkëngjitur, Komisioni më tutje vendos që kërkesat të hidhen poshtë për aq sa

paraqitësit e kërkesave kërkojnë kompensim për dëmin material apo për humbjen e shfrytëzimit, të pronës së kërkuar;

- (5) *Në rastet kur ka më shumë se një pronar, vendimet dhe urdhri i mësipërm nuk ndikojnë në të drejtat e asnjërit prej bashkëpronarëve përkatës.*

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës ("Kuvendi") ka miratuar Ligjin Nr. 03/L-079 duke miratuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 ("UNMIK/REG/2006/50") mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili miraton dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut Nr. 2007/5 ("UNMIK/ADM/DIR/2007/5"), e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin Nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("KPA") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji Nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushon së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji Nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit Nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedit të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079).

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposedit në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës

në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhresës Administrative nr. 2007/5 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

5. Komisioni mbajti seancën e njëzet e tretë nga 20 deri 22 qershor 2011 në Prishtinë. Gjithsej i janë paraqitur Komisionit 2,548 kërkesa për pronë bujqësore në seancën e njëzetë e tretë, nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së ("Sekretaria Ekzekutive"), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata të tjera relevante.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesat për pronësi.

7. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim, paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës për pronësinë dhe që të gjitha kanë të bëjnë me pronat bujqësore, përfshirë arat, kullotat dhe pyjet.

8. Ky vendim trajton 25 kërkesa për pronë bujqësore të cilat janë të shënuara në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur. Bazuar në shqyrtimin e kërkesave dhe të dokumenteve mbështetëse gjatë seancës dhe informacionin e ofruar dhe verifikimin e kryer nga Sekretaria Ekzekutive, gjithsej pesë kërkesa për pronë bujqësore iu kthyen Sekretarisë Ekzekutive nga Komisioni për shqyrtim shtesë apo verifikim, dhe tri kërkesa u tërhoqën nga Sekretaria Ekzekutive gjatë seancës. Kërkesat të cila janë shënuar në pjesën C ("kërkesat e kthyer") të listës së bashkangjitur këtij vendimi, do të shqyrtohen nga Komisioni në kohën e duhur. Komisioni ndërpreu shqyrtimin e një kërkesë në pritje të mbajtjes së seancës dëgjimore. Pjesa e mbetur prej 2,517 kërkesash për prona bujqësore të shqyrtuara nga Komisioni gjatë kësaj seance përfshihen në dy vendimet e tjera, pikërisht vendimin KPCC/D/A/112/2011 dhe vendimin KPCC/D/A/113/2011.

9. Gjithsej 21 nga 25 kërkesa të përfshira në këtë vendim nuk janë shqyrtuar më parë nga Komisioni, ndërsa katër kërkesa kanë qenë subjekt i një vendimi të mëparshëm të Komisionit. Megjithatë, vendimi i mëparshëm në këto kërkesa është shfuqizuar nga Komisioni për shkak të notifikimit të pasaktë të pronave të kërkuara gjatë përpunimit të kërkesës nga Sekretaria Ekzekutive. Për rrjedhojë, këto kërkesa

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksit e saj, Neni 26 i Aneksit i parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksit e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksit e Urdhresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislative dhe Komisioni do t'u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksit I, II dhe III, respektivisht.

duhet të rivendosen pas notifikimit të saktë të pronave të kërkuara duke marrë në konsideratë çfarëdo informacioni të ofruar nga palët përgjegjëse ose uzurpuesit aktual të pronave. Në kërkesat të cilat janë vendosur më parë e janë shfuqizuar nga Komisioni, Sekretaria Ekzekutive u ka shkruar paraqitësve të kërkesave duke i informuar ata për gabimet e notifikimit dhe i ka informuar se kërkesa do të rivendoset pas notifikimit të saktë të pronës të kërkuar. Paraqitësit e kërkesës si dhe autoritetet kadastrave përkatëse janë informuar se vendimet e mëparshme të Komisionit janë pavlerë dhe nuk mund të përdoren për qëllimet e çfarëdo transaksioni ligjor.

10. Të gjithë kërkesat e përfshiera në këtë vendim janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronat e kërkuara ose pala që ka shprehur interes ligjor në këto prona ("pala përgjegjëse") e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda afatit 30 ditor të përcaktuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedurës në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Në bazë të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, secilës prej palëve përgjegjëse i është dorëzuar një kopje e kërkesës të parashtruar nga paraqitësi përkatës i kërkesës. Në bazë të nenit 3.5 të Aneksit II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësve të kërkesave u është dorëzuar një kopje e dokumenteve të parashtruara nga palët respektive përgjegjëse në kërkesë. Të dy palëve, në secilën rast, u është dhënë mundësia të komentojnë për informacionin e ofruar nga pala tjetër, edhe komentet apo informacioni i tillë është marrë në konsideratë gjatë përpunimit dhe vendosjes të kërkesës.

11. Në njëzet kërkesat e përmendura në pjesën A të listës së bashkëngjitur, Komisioni vëren se paraqitësit e kërkesave kanë paraqitur lloje të ndryshme të dokumenteve në mbështetje të kërkesave për pronësinë, përfshirë fletët poseduese, kontratat e shitblerjes, kontratat e dhurimit, kontratat për ndarjen e pronës, vendimet për trashëgiminë, vendimet e gjykatës për njohjen e pronësisë, kontratat për përkujdesjen jetësore dhe certifikatat për të drejtat e pronës së paluajtshme. Komisioni është i kënaqur se vendimet e gjykatës së formës së prerë dhe certifikatat për të drejtat e pronës së paluajtshme që konfirmojnë interesin pronësor me të vërtetë përbëjnë dëshmi të pronësisë. Dokumentet e tjera të dorëzuara nga paraqitësit e kërkesave përfshirë fletët poseduese dhe kontratat që përfshijnë transaksione pronësore krijojnë një supozim të kundërshtueshëm të së drejtës pronësore. Dokumentet janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si të vlefshme dhe konsiderohen si relevante. Disa paraqitës të kërkesave kanë paraqitur gjithashtu dokumente mbështetëse shtesë, përfshirë vendimet për tatimin, deklaratat e dëshmitarëve, kopjet e planeve dhe vendimeve kadastrale.

1. Kërkesat nr. 23728, 23747, 23745, 27936, 54720, 54723, 54736 dhe 48541.

12. Në kërkesat nr. 23728, 23747, 23745, 27936, 54720, 54723 dhe 54736 paraqitësit e kërkesave kanë paraqitur kërkesat e tyre në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore, pikërisht fëmijët e mbajtësit të së drejtës pronësore. Në kërkesën nr. 48541 paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore.

13. Palët respektive përgjegjëse janë uzurpuesit aktualë të pronave. Ata kanë nënshkruar njoftimin e pjesëmarrjes, por nuk kanë kërkuar të drejtë ligjore për pronën.

Megjithatë, ata pranojnë se paraqitësit përkatës të kërkesave ose mbajtësit e së drejtave pronësore, sipas rastit, iu kanë dhënë atyre leje për te shfrytëzuar pronat. Palët përgjegjëse u kontaktuan nga Sekretaria Ekzekutive dhe iu kërkua atyre të ofrojnë dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tyre, megjithatë, ata kanë dështuar të ofrojnë provat e tilla.

14. Paraqitësit e kërkesave e mohojnë se ata ose mbajtësit e së drejtave pronësore, sipas rastit, t'u kenë dhënë palës përgjegjëse lejen të shfrytëzojnë pronat e kërkuara.

15. Pasi paraqitësit e kërkesave kanë provuar të drejtën pronësore për pronat e kërkuara ose të drejtën pronësore të mbajtësve të së drejtës pronësore sipas rastit, në mungesë të një mbrojtje të vlefshme nga ana e palëve përgjegjëse, kërkesat duhet të miratohen.

2. Kërkesa nr. 16008.

16. Në kërkesën nr. 16008, paraqitësja e kërkesës Nadezda Jovanovic ka depozituar kërkesë në cilësinë mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësja e kërkesës deklaroi se ajo është pronare e pronës së kërkuar bazuar në fletën poseduese nr. 361 dhe kontratën e dhurimit të vitit 1980 të lëshuar nga nëna e saj e ndjerë Leposave-Savke. Të dy dokumentet janë verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive. Paraqitësja e kërkesës pohon gjithashtu se prona e saj është uzurpuar kundër dëshirës së saj dhe se në pronë është ngritur një ndërtim banesor pa lejen e saj. Bazuar në notifikimin e pronës së kërkuar të bërë nga Sekretaria Ekzekutive, ndërtimi i tillë ekziston. Uzurpuesi aktual i pronës, Luan Fazliu ("pala përgjegjëse"), pretendon se dikur në vitin 2000 ai u kontaktua nga një person i panjohur i cili iu prezantua atij si pronar i pronës së kërkuar. Ai nënshkroi një kontratë blerje me këtë individ dhe pretendon se i ka paguar atij si depozitë shumën DM 2,000. Nuk janë bërë pagesa të tjera. Pala përgjegjëse deklaroi se më vonë ai zbuloi se individi prej të cilit ai kishte blerë pronën, nuk ishte pronari i pronës dhe ai pretendon të jetë në kontakt me paraqitësen e kërkesës përmes një avokati për të negociuar blerjen e pronës.

17. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive përsëri më 25 janar 2011, pala përgjegjëse pretendoi se në vitin 2000 ai kishte qene në kontakt me anëtarët e familjes së paraqitëses së kërkesës për të negociuar kontratën e blerjes. Megjithatë, nuk është arritur asnjë marrëveshje përfundimtare midis palëve.

18. Kur u kontaktua përsëri nga Sekretaria Ekzekutive, paraqitësja e kërkesës konfirmoi deklaratën e saj fillestare se as ajo vetë dhe as përmes përfaqësuesit të saj apo anëtarëve të familjes, kurrë nuk kishte dhënë pëlqimin për transferimin e së drejtës pronësore ose nuk e kishte lejuar palën përgjegjëse për të shfrytëzuar pronën.

19. Komisioni konsideron se pala përgjegjëse ka qenë e vetëdijshme gjatë uzurpimit të pronës së kërkuar se prona nuk i takon atij, dhe se ai nuk ka pasur leje për ta shfrytëzuar pronën. Rrjedhimisht, pala përgjegjëse duhet të kishte kuptuar se ngritja e pronës banesore në pronë ishte e paligjshme dhe për rrjedhojë ai nuk ka të drejtë për pronën e kërkuar. Rrjedhimisht, kërkesa e paraqitëses së kërkesës duhet të miratohet dhe duhet të lëshohet urdhër dëbimi si më sipër.

3. Kërkesat nr. 11646, 11647, 11648, 11651 dhe 11652 vs. 13823, 13824, 13825 dhe 13828

20. Kërkesat nr. 13823, 13824, 13825 dhe 13828 janë parashtruar nga i njëjti paraqitësi i kërkesave në lidhje me të njëjtat prona të cilat janë kërkuar nga paraqitësi i kërkesës në kërkesat nr. 11646, 11647, 11648, 11651 dhe 11652, respektivisht. Paraqitësi i kërkesës në kërkesat nr. 11646, 11647, 11648, 11651 dhe 11652 ("paraqitësi i parë i kërkesës") i parashtrroi kërkesat në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, ndërsa paraqitësi i kërkesës në kërkesat nr. 13823, 13824, 13825 dhe 13828 ("paraqitësi i dytë i kërkesës") depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Të dy paraqitësit e kërkesave kontestojnë të drejta pronësore të njëri tjetrit.

21. Paraqitësi i dytë i kërkesës parashtrroi kërkesat fillimisht në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të babait të tij Trajko Nikolic, mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore. Pas depozitimit të kërkesës dhe në bazë të procedurës së trashëgimisë, paraqitësi i kërkesës u bë bashkëpronar me vëllezërit/motra e tij në 1/5 pjesë ideale të pronës së kërkuar. Në mbështetje të pretendimit të tij, ai parashtrroi fletën poseduese nr. 138 në emër të babait të tij dhe vendimin e trashëgimisë të datës 22 nëntor 2010, e cila e tregon paraqitësin e kërkesës si bashkëpronar në pjesën ideale prej 1/5 të pronës së kërkuar. Të dy dokumentet janë verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive.

22. Paraqitësi i parë i kërkesës parashtrroi kërkesat e tij në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të babait të tij Serif Kurtisaj. Paraqitësi i parë i kërkesës pretendon se pronat e kërkuara i takonin gjyshit të tij deri në vitin 1938, kur e drejta pronësore iu dha familjes së paraqitësit të dytë të kërkesës me vendim të Gjykatës Supreme të Shkupit. Paraqitësi i parë i kërkesës pohon gjithashtu se gjatë vitit 1990 familja Nikolic e detyroi paraqitësin e parë të kërkesës t'ia blinte pronën përsëri, megjithatë, Paraqitësi i parë i kërkesës dështoi të ofrojë ndonjë provë në mbështetje të transaksionit të pretenduar.

23. Paraqitësi i dytë i kërkesës pohoi se ai e humbi posedimin e pronave të kërkuara për shkak të konfliktit, ndërsa Paraqitësi i parë i kërkesës pretendon se gjyshi i tij e humbi posedimin në vitin 1938 dhe e rimori pronën në posedim vetëm pas konfliktit të vitit 1999. Sekretaria ka verifikuar *ex officio* vendimin e trashëgimisë në emër të paraqitësit të dytë të kërkesës e cili i tregon atë si bashkëpronar të pjesës ideale prej 1/5 të pronave të kërkuara se bashku me vëllezërit e tij dhe konstatoi atë të vlefshëm.

24. Komisioni konstaton që paraqitësi i dytë i kërkesës, ka treguar se ai është bashkëpronar i pjesës ideale prej 1/5 të pronave kontestuese dhe se ai nuk ka mundësi të ushtrojë të drejtën pronësore për shkak të rrethanave që e kanë zanafillën në konfliktin e vitit 1998-99. Rrjedhimisht, kërkesat e parashtruara nga paraqitësi i dytë i kërkesës duhet të miratohen.

25. Në lidhje me kërkesat e parashtruara nga Paraqitësi i parë i kërkesës, është e dukshme që humbja e pretenduar e posedimit nuk ndërlidhet me konfliktin e vitit 1998-99; në të vërtetë Paraqitësi i parë i kërkesës deklaroi se gjyshi i tij e humbi posedimin në vitin 1938. Rrjedhimisht, kërkesat e Paraqitësit të parë të kërkesës bien jashtë juridiksionit të Komisionit e duhet të hidhen poshtë.

4. Kërkesat nr. 25513, 25514, 25515, 25516, 25517, 25518 dhe 90078

26. Kërkesat nr. 25513, 25514, 25515, 25516, 25517, 25518 dhe 90078 u depozituan fillimisht nga Miroslav Mihajlovic në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, pikërisht babait të tij Bozidar Mihajlovic. Gjatë procesit të përpunimit të kërkesave, më 16 prill 2009, Miroslav Mihajlovic ndërroi jetë dhe Bozidar Mihajlovic deklaroi se djali i tij, Branislav Mihajlovic (paraqitësi aktual i kërkesës”) do të vepronte në emër të tij në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare.

27. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës pronësore dhe riposëdimin e pronave të kërkuara. Paraqitësi i kërkesës parashtrori fletën poseduese nr. 438 datë 24 shtator 2001 që e tregon babain e paraqitësit të kërkesës si pronar të pronave të kërkuara, kontratën e blerjes të datës 15 prill 1994, që pretendohet se është nënshkruar midis babait të paraqitësit të kërkesës dhe Xhelal Halabakut në lidhje me pronat e kërkuara, aktgjykimin e formës së prerë të lëshuar nga Gjykata Komunale e Vitisë date 14 shtator 2009, e cila e shpall të pavlefshme kontratën nr. 329/02 të nënshkruar mes përfaqësuesit të pretenduar të babait të paraqitësit të kërkesës dhe Z. Halabaku. Gjykata konstatoi se kontrata është nënshkruar në bazë të një autorizimi të falsifikuar. Më tej, është nxjerrë një vendim nga Zyra Komunale Kadastrale e Vitisë e cila e miraton kërkesën e babait të paraqitësit të kërkesës për të regjistruar pronat e kërkuara në emër të tij, bazuar në aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Vitisë.

28. Pala përgjegjëse (Xhelal Halabaku) pretendon se ai i ka blerë pronat e kërkuara nga babai i paraqitësit të kërkesës Bozidar Mihajlovic. Pala përgjegjëse pretendon se ai i ka blerë ngastrat e kërkuara në prani të një avokati e disa dëshmitarëve. Në mbështetje të pretendimeve të tij, pala përgjegjëse ka paraqitur një kontratë blerje datë 10 maj 2002, midis Afrim Halabakut si përfaqësues i babait të paraqitësit të kërkesës dhe palës përgjegjëse. Megjithatë kjo kontratë blerje është deklaruar a pavlefshme në bazë të vendimit 185/2007 datë 14 shtator 2009 të Gjykatës Komunale në Viti.

29. Bazuar në dëshmitë e paraqitura nga Paraqitësi i kërkesës, Komisioni arrin në përfundimin se paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar kërkesën e tij pronësore dhe Komisioni konstaton gjithashtu që paraqitësi i kërkesës ka humbur posedimin e pronës së kërkuar si rezultat i konfliktit të armatosur të vitit 1998-99 dhe kërkesa duhet të miratohet.

B. Vërejtjet përmbledhëse.

30. Vendimet dhe urdhri i mësipërm i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rast, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar.

31. Në bazë të nenit 8.5 të aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni mundet të vendosi në vendimin e tij për të drejtën pronësore në emër të bartësit të së drejtës pronësore edhe të nxjerrë urdhër për posedimin në dobi të paraqitësit të kërkesës. Në rastet kur bartësi i së drejtës pronësore është i gjallë, Komisioni miraton të drejtën e posedimit në emër të bartësit të së drejtës pronësore. Në rastet kur bartësi i së drejtës pronësore ka vdekur e vdekja është provuar por nuk është siguruar vendim i vlefshëm për trashëgiminë, Komisioni miraton posedimin për paraqitësin e kërkesës si anëtar i bashkësisë familjare të bartësit

të së drejtës pronësore. E drejta e posedimit miratohet në bazë të dispozitave të ligjit në fuqi që rregullon marrëdhëniet familjare në Kosovë, i cili përfshin administrimin e pronës familjare si dhe duke iu referuar ligjit në fuqi për trashëgiminë. Vendimi i Komisionit për të drejtën e posedimit të pronës nga paraqitësi i kërkesës si anëtar i bashkësisë familjare nuk cenon të drejtën e anëtarëve të tjerë të bashkësisë familjare, ose trashëgimtarëve të tjerë, të bartësit të së drejtës pronësore të cilët nuk kanë depozituar kërkesë në KPA, por të cilët mund të kenë të drejtë të përbashkët për posedimin e pronës në bazë të ligjit në fuqi ose si rrjedhojë e procedimit për trashëgiminë në të ardhmen. (neni 8.5 i aneksit III të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079).

32. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 të miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo aplikohet në rastin konkret.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Informacione shtesë lidhur me procedurën e ankesave gjenden në Faqen e veçantë të Informacioneve për Ankesa e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

*** Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze.**

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part A/Pjesa A/Deo A

KPA23747	KPA23745	KPA27936	KPA48541	KPA54720	KPA54736	KPA23728
KPA54723	KPA13823	KPA13824	KPA13825	KPA13828	KPA16008	KPA25513
KPA25514	KPA25515	KPA25516	KPA25517	KPA25518	KPA90078	

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part B/Pjesa B/Deo B

KPA11646	KPA11647	KPA11648	KPA11651	KPA11652		
----------	----------	----------	----------	----------	--	--